



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 657/3 Prot

Tiranë, më 10.09.2021

V E N D I M

Nr.106, datë 10.09.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procesit administrativ të dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, të nëpunëses *** punësuar në pozicionin “Specialist për Kadastrën dhe Tokën Bujqësore”, në Njësinë Administrative Lis, Bashkia Mat.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej nëpunëses Dallandyshe Koleci.

Vërej se:

Nëpunësja ***** , nëpërmjet një kërkesë të protokolluar me nr. 657 prot., datë 03.06.2021, prej nëpunëses, ka ngritur pretendimin se vendimi nr. 01 (597 prot.) datë 4.02.2021 “Vendim përfundimtar”, i Komisionit të Disiplinës, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, është i pabazuar në ligj dhe në prova.

Mbi bazën e informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi paraprak i këtij rasti nga Komisioneri, duke kërkuar sqarimet dhe dokumentacionin e nevojshëm prej Bashkisë Mat, nga përmbajtja e të cilave rezultoi si më poshtë:

Nëpunësja në fjalë, është nëpunëse civile, në pozicionin “Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, pranë Njësisë Administrative Lis”, në Bashkinë Mat, (akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 1810 prot., datë 17.07.2021), për rrjedhojë, bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin

e ligjshmërisë së një procedure administrative, përfshihet në juridiksionin e çështjeve që mund të mbikëqyren prej Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kërkesa e paraqitur përmban pretendime në lidhje me ligjshmërinë e zhvillimit të një ecurie disiplinore ndaj saj, proces që është përmbyllur me aktin nr. 01 (597 prot.) datë 4.02.2021 “*Vendim përfundimtar*”, të Komisionit të Disiplinës”, nëpërmjet të cilit është vendosur marrja e masës disiplinore “*Lirim nga shërbimi civil*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore (*akte të administruara nëpërmjet E-mailit të datës 28.06.2021 nga Njësia e Përgjegjëse e Bashkisë Mat:- relacioni paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm në datën 03.12.2020 për shkeljet e pretenduara; shkresa nr.5349 prot., datë 07.12.2020 e Kryetarit të Bashkisë, që miraton kërkesën e eprorit direkt për fillimin e ecurisë disiplinore, i vijuar më tej me vendimin e tij për fillimin e procedimit disiplinor, akti nr. 5349 prot., datë 07.12.2020, i eprorit direkt dhe përcjelljen e shkeljes disiplinore Komisionit të Disiplinës*), deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, (*vendimi nr. Nr. 01 (597 prot.) datë 4.02.2021 “Vendim përfundimtar”, të Komisionit të Disiplinës, për marrje mase disiplinore “Largim nga shërbimi civil”*), konstatohet:

Komisioni i Disiplinës, ngritur me urdhrin nr. 780 (5345 prot.) datë 07.12.2020, “*Për plotësim të Komisionit të Disiplinës*”, të kryetarit të Bashkisë Mat, rezulton se është me përbërje të rregullt, sipas përcaktimit të pikës 2, të kreut I, “*Organet disiplinore*”, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 5349 prot., datë 07.12.2020, “*Njoftim fillim ecurie disiplinore*”, ankuesja, është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor për shkelje shumë të rënda të disiplinës më punë, parashikuar nga pika 2, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në të njëjtën kohë, është caktuar edhe seanca dëgjimore për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar.

Në seancat dëgjimore të caktuara nga KD (*data 15.12.2020 ora 10.00 dhe datë 23.12.2020 ora 10.00*) për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, nëpunësja në procedim nuk është paraqitur duke parashtruar pretendime për gjëndjen jo të mirë shëndetësore, duke paraqitur për këtë dhe raport mjekësor nga mjeku i familjes (*i cili është marrë parasysh nga Komisioni i Disiplinës, duke i dhënë mundësinë e një date tjetër, pikërisht në datën 27.01.2021, fakte këto që vërtetohen nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura, shoqëruar kjo me vendimet përkatëse të ndërmjetme, për pezullim apo shtyrje të afateve procedurale disiplinore*).

Në datën 27.01.2021, ora 10.10, me paraqitjen e punonjësës *****, është zhvilluar seanca e shqyrtimit të çështjes disiplinore, e cila me dakortësinë e palëve, është regjistruar (*procesverbali i mbajtur me këtë rast datë 27.01.2021*).

Në përfundim të diskutimeve dhe pas analizës së dokumentacionit, Komisioni i Disiplinës ka vendosur mbylljen e seancës dhe kalimin në shqyrtimin e provave dhe fakteve duke përcaktuar datën 01.02.2021, ditën e shpalljes së vendimit përfundimtar.

Në arsyetimin e vendimit të Komisionit të Disiplinës, është arritur në përfundimin se punonjësja *****, ka kryer shkelje shumë të rënda disiplinore, parashikuar nga pika 2/a, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, të cilat konsistojnë në moszbatimin e urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, nr. 119 datë 17.02.2020 "*Për ngritjen e Komisionit për verifikimin në terren të ankesës së praqitur nga ***** ndaj ******" dhe urdhërit nr. 120, datë 17.02.2020 "*Për ngritjen e komisionit të verifikimit në terren të ankesës së paraqitur nga ***** ndaj ******", gjë që ka sjellë mosrealizim të detyrave të caktuara, të cilat janë shoqëruar me .

Me këtë motivacion, në përfundim të procedurës, nëpërmjet aktit administrativ nr. 01 (597 prot.) datë 4.02.2021 "*Vendim përfundimtar*", Komisioni i Disiplinës ka vendosur marrjen e masës disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*", ndaj punonjësës në fjalë, vendim i cili në zbatim të pikës 20, kreu II, "*Procedura disiplinore*", të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*", i ndryshuar, i është njoftuar nëpunësës Dallëndyshe Koleci, me aktin nr. 622, datë 05.02.2021 "*Dërgojmë vendimin e Komisionit të Disiplinës*".

Gjatë zhvillimit të këtij hetimi administrativ, u konstatua gjithashtu se nëpunësja në fjalë, ndërkaq i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ Nr. 01 (597 prot.) datë 4.02.2021 të Komisionit të Disiplinës Bashkia Mat "*Për lirim nga shërbimi civil të punonjësës Dallandyshe Koleci me detyrë "Specialist për kadastrën dhe Tokën Bujqësore" në Njësinë Administrative Lis, Bashkia Mat*", organi i cili ka filluar shqyrtimin e çështjes.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, "*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*", sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me me *nr. 657 prot., datë 03.06.2021*, në lidhje me procedurën disiplinore ndaj nëpunëses ***** dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga organet gjyqësore.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Mat dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha